



Titulli i Pozicionit: Teknik i Rrjetit dhe Sistemit të Teknologjisë Informative

Sektori : Teknologjia Informative

Përshkrimi i punës

Agjencioni për Financim në Kosovë-AFK kërkon një Teknik të Rrjetit dhe Sistemit të Teknologjisë Informative që do të jetë përgjegjës për instalimin, konfigurimin e sistemeve operative, monitoron performancën, kryej mirëmbajtjen rutinore dhe përkrahje të rrjetit dhe infrastrukturës së data komunikimeve në AFK. Do të përfshihen sistemet operative, aplikacionet dhe serverët, sistemet e e-mail, sistemet e fajllave dhe printerëve, mbrojtjes anti-virus, qasjeve remote, sigurisë së rrjetit dhe komunikimeve voice dhe data.

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi (por nuk janë të limituara në):

- Ofron/ siguron përkrahje në të gjitha nivelet për shfrytëzuesit e sistemit te AFK-së për problemet me hardware/ software (në zyrën qendrore dhe/ ose zyrat rajonale).
- Instalon, mirëmban dhe rregullon sistemet operative (Windows), aplikacionet sofverike, bënë azhurnimet e nevojshme për siguri të sistemeve dhe teknologjive anti-virus, për një mjedis të sigurtë të sistemit.
- Mirëmban qasjet e shfrytëzuesve dhe politikat e grupeve brenda data-bazës Active Directory për (Microsoft) Domain Kontrolleret e organizatës.
- Mirëmban dhe rregullon qasjet për VPN Remote Access, sipas kërkesave.
- Menaxhon dhe kujdeset për backup/ recovery në nivel të sistemeve dhe fajllave të sistemit.
- Mirëmban dhe përkrah serverët (në përgjithësi në mjedis virtual)
- Rregullon dhe zgjidhë problemet me konfigurimet e ndryshme harduerike dhe të infrastrukturës në përgjithësi (përfshirë pajisjeve të rrjetit, printerëve, etj.)

Kualifikimet e kërkuara/përvoja

- Bachelor i shkencave kompjuterike (ose relevante) dhe/ ose Certifikime nga industria e TI-së (Microsoft, Cisco, CompTIA, etj.) do të konsiderohen përparësi.
- Përvoja me IT Services Desk, rrjeta kompjuterike, desktop dhe serverë është e preferuar.
- Të ketë njohuri mbi konceptet bazike të rrjetit dhe praktikat e procedurat e përdorimit të veglave për sistemet operative të Microsoft.
- Njohuritë ose përvoja me mjediset dhe platformat e virtualizimit (desktop/ server) është e dëshiruar.
- Te posedojë patent shoferi.

Njohuritë/aftësitë e dëshiruara

- Aftësi të shkëlqyeshme verbale dhe në të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.
- I/e gatshme që të marr iniciativa dhe të jetë e adaptueshme ndaj ndryshimeve.

- Te interesuarit mund ta shkarkojnë Aplikacionin për punësim nga web faqja zyrtare:
www.afkonline.org

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit: recruitment.hr@afkonline.org

Afati i aplikimit është deri më datë 8 Qershor, 2021 ora 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në rrethin e ngushtë do të ftohen për procedura të mëtutjeshme.